



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr-410-44183

Më datë 21 korrik 2022

Ne baze te nenit 13 dhe nenit 58, paragrafi 1, shkronja (b) dhe (g), të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, publikuar në “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008”, e në mbështetje të nenit 44, lidhur me nenin 131 dhe 132, të Ligjit Nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.20/2016” e konform neneve 30 dhe 45, paragrafi 1 shkronja (a) dhe (e) të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit të ankesave

1. **Formohet komisioni i ankesave** për shqyrtimin e ankesave që parashtrohen kundër vendimeve të organit të shkallës së parë në procedur administrative, brenda Komunës së Suharekës në këtë përbërje:
 - 1.1 **Ramadan KUQI**-----kryesues
 - 1.2 **Shkelqim SALIHU**-----anëtar
 - 1.3 **Berat KABASHI**-----anëtar
2. Detyrë dhe përgjegjësi e këtij komisioni është që të bënë shqyrtimin dhe të vendos lidhur me ankesat që parashtrohen kundër vendimeve të organit të shkallës së parë në procedur administrative brenda Komunës së Suharekës, konform Ligjeve dhe akteve nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Kopje:
Drejtoritë
Komisionit
Arkiva



Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ